



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKT-VENDIM

Nr. ____/2019

“PËR

NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR KONTROLLIN E LIGJSHMËRISË SË VEPRIMEVE TË KRYERA NGA ANA E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KUADËR TË USHTRIMIT TË KOMPETENCAVE TË TIJ LIDHUR ME ZHVILLIMIN E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE”

Në mbështetje të nenit 7 dhe 78 të Kushtetutës, të nenit 3, pika 3, nenit 5, pika 2, nenit 8 pika 1 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të neneve 55 dhe 112, pika 3 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e komisionit të Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut, bazuar në kërkesën e 55 deputetëve për shkarkimin e Presidentit të Republikës,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

1. Ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh, për të kontrolluar ligjshmërinë e veprimeve të kryera nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

2. Ky hetim ka për qëllim njohjen si dhe verifikimin e mënyrës së ushtrimit të kompetencave nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore në përputhje me parimet kushtetuese si parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve, shteti i së drejtës dhe demokracinë funksionale, si dhe nxjerrjen e përgjegjësisë konkrete institucionale.

3. Objekt i punës së komisionit hetimor është:

a) Verifikimi i procedurave të ndjekura nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë gjatë ushtrimit të kompetencave të lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore;

b) Hartimin e akteve si dhe efektet e tyre juridike në raport me kompetencat e Presidentit të Republikës së Shqipërisë;

c) Pasojat e këtyre akteve në raport me institucionet e tjera të Republikës së Shqipërisë si, Kuvendi, Këshilli i Ministrave Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, apo Gjykatat.

ç) Sjellja dhe qëndrimi të caktuara të Presidentit të Republikës në raport me rolin dhe pozitën e tij kushtetuese.

4. Komisioni hetimor parlamentar përbehet nga 9 deputetë, si më poshtë:

1. Ulsi Manja	Kryetar
2. Alban Zeneli	Zëvendëskryetar
3. Vasilika Hysi	Anëtare
4. Klotilda Bushka	Anëtare
5. Bashkim Fino	Anëtar
6. Alket Hyseni	Anëtar
7. Adriatik Alimadhi	Anëtar
8. Halit Valteri	Anëtar
9. Krenar Rryçi	Anëtar

Anëtarë zëvendësues caktohen:

1. Adnor Shameti	Grupi parlamentar PS
2. Spartak Braho	Grupi parlamentar PS
3. Arlind Çaçani	Grupi "Demokrat"
4. Zef Shtjefni	Grupi "Partitë e Djathta"

5. Komisioni hetimor, i ngritur sipas këtij vendimi, bashkë me raportin përfundimtar i paraqet Kuvendit në mënyrë të arsyetuar nëse ekzistojnë shkaqet për shkarkimin e Presidentit të Republikës.

6. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat 3-mujor nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

7. Ngarkohen Kryetari i Kuvendit që menjëherë të caktojë mjediset dhe mjetet e punës së komisionit, si dhe personelin e nevojshëm, duke vënë në dispozicion edhe ekspertë juriste.

8. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit që të marrë masa për zbatimin e vendimit të Kuvendit dhe të urdhrave të Kryetarit të Kuvendit, për mbarëvajtjen e punës së komisionit, si dhe krijimin e kushteve të nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar më ____/____/2019

KRYETARI

GRAMOZ RUÇI